



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2019:084655

Datë: 06.10.2022

Numri i dokumentit: 03496004

P.nr.146/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA KAÇANIK Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtari Burim Çaka, procesmbajtësja Suzane Rudi, në çështjen penale kundër të akuzuarit I. A. nga fshati ..Komuna e Kumanovës Republika e Maqedonisë së Veriut, për shkak të veprës penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj me numër PP/II.nr.530-10/2019 të datës 25.03.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik më datë 20.09.2022 në praninë e Prokurores së Shtetit Mimoza Syla Hyseni dhe të akuzuarit, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 06.10.2022 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuar: I. A. nga Fshati ... Komuna e Kumanovës Republika e Maqedonisë se Veriut, i lindur më datë, ... nga i ati Xh... dhe e ëma H... e gjinisë M... , me numër personal ..., ka të kryer Fakultetin e Bazave të Fesë Islame-Riad, punon në Bashkinë Islame të Maqedonisë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës e Kosovës, i pa gjykuar më parë, mbrohet në liri

Në bazë të nenit 364, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP)

LIROHET NGA AKUZA

Sepse më datë 08.02.2019, rreth orës 14:40, në pikën kufitare Hani i Elezit Republikë e Kosovës – Republika e Maqedonisë Veriore, me dije përdor dokumentin e falsifikuar me qëllim shfrytëzimit të atij dokumenti si origjinal, në atë mënyrë që gjatë kontrolleve doganore, i njëjti ka prezantuar për kontroll letërnjoftimin, patentë shoferin, librezën e veturës dhe sigurimin kufitar. Policia gjatë kontrollimit të këtyre dokumenteve ka vërejtur që dokumenti – sigurimi kufitar (kartoni i gjelbër i MKD-së), me numër MK/..., i mungonin disa tipare të sigurisë si logoja, planshetet dhe kualifikimi i letrës është i dobët, dokumenti në fjalë është i falsifikuar të cilën e ka vërtetuar ekspertiza e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë dhe i njëjti është sekuestruar.

- Me të cilat veprime do të kryente veprën penale Falsifikim i dokumentit nga neni 398 paragrafi 1 të KPRK-së.

- Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.530-10/2019 të datës 25.03.2019, kundër të akuzuarit së lartë shënuar për shkak të veprës penale Falsifikim i dokumentit nga neni 398 paragrafi 1 të KPRK-së dhe ka kërkuar që e njëjta të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Pretendimet e palëve gjatë shqyrtimit gjyqësor

Prokurorja e Shtetit gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe fjalës përfundimtare ka deklaruar se mbetëm në tersi pranë Aktakuzës me numër PP.nr. 530-10/2019 të datës 25.03.2019, pas administrimit të provave në këtë shqyrtim Gjyqësor si prova materiale raporti i oficeri, raporti i ekspertimit të agjencisë Kosovare për forenzikë i datës 12.02.2019, foto dokumentacioni dhe

forma daltimostofike e datës 08.02.2019, pas administrimit të provave do të vërtetohet gjendja faktike sikurse në aktakuzë, si dhe pjesërisht mbrojtja e të pandehurit u vërtetua gjendja faktike sikurse në aktakuzë. Andaj i propozoj gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ti shqiptoj sanksion penal të paraparë me ligj.

I akuzuari gjatës shqyrtimit gjyqësor dhe fjalës përfundimtare e ka mohuar në tërësi kryerjen e veprës penale dhe ka deklaruar se argumentet nga Byroja Nacionale e Sigurimeve të Maqedonisë Veriore, janë shumë të qarta, po ashtu edhe nga Kompania e Sigurimeve Ndërsa sa i përket letrës është çështje e kompanisë e jo e imja si person fizik.

Provat e administruara gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor

Është lexuar raporti i ekspertimit i Agjencisë së Kosovës për forenzikë me numër AKF/2019-0340/2019-297 e datës 12.02.2019, procesverbali mbi marrjen në pyetje e të pandehurit e dhënë në Stacionin Policor në Han të Elezit e datës 02.08.2019, raporti fillestar i incidentit i datës 08.02.2019, raporti i oficerit E.K i datës 08.02.2019, formular i konfiskimit të dokumenteve i datës 08.02.2019, dy fotografi të kartonit të gjelbër, Kartoni i gjelbër, shkresë nga Kompania ... me numër 0306/21573 e datës 04.11.2020 në origjinal, vërtetim nga noteri S. K. i datës 05.11.2020, kartoni i gjelbër i nxjerrë nga sistemi i kompanisë ..., i noterizuar dhe i përkthyer në gjuhën shqipe, njoftim nga Byroja Kombëtare për Sigurimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut e datës 06.11.2020 me numër të referencës 08.09.-497/1-2019 e motorizuar dhe e përkthyer në gjuhën shqipe.

Gjetjet e gjykatës lidhur me faktet

Gjykata ka analizuar dhe vlerësuar një nga një dhe të gjitha bashkërisht të gjitha provat që janë administruar gjatë seancës të shqyrtimit gjyqësor, ku pas analizimit të të gjitha këtyre provave, ka ardhur në përfundim se nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale Falsifikim i dokumentit nga neni 398 paragrafi 1 të KPRK—së duke u bazuar në këto fakte vendimtare të provuara:

Gjykata vlerëson se për tu kryer vepra penale Falsifikim i dokumentit nga neni 398 paragrafi 1 të KPRK-së, kryerësi duhet që veprën penale ta kryej me dashje direkte.

Gjykata vlerëson se nga provat të cilat janë administruar në shqyrtim gjyqësor janë vërtetuar këto fakte vendimtare:

Sigurimi kufitar – kartoni i gjelbër i MKD –së me numër serik MK/..., përkundër cilësisë së letrës në të cilën ka qenë i shtypur, përmbajtja ka qenë origjinale dhe i lëshuar në mënyrë të rregullt, këtë fakt Gjykata e vërtetoi nga:

- Dokumenti i lëshuar në gjuhën angleze nga Byroja Kombëtare për Sigurim e Republikës së Maqedonisë Veriore e datës 06.11.2020 me numër Ref.0809-497/1-2019 i përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar, me të cilin vërtetohet se kartoni i gjelbër me numër MK/... është lëshuar nga sistemi qendror i Byroja Kombëtare për Sigurim e Republikës së Maqedonisë Veriore në emër të V. I. me periudhë vlefshmërie të kartonit të gjelbër nga data 25.01.2019 deri më 05.06.2019, i autorizuar për ta përdorur këtë veturë ka qenë Ismet Ademi

Po ashtu ky fakt u vërtetua edhe nga vërtetim i polisës, dokument i noterizuar i lëshuar nga Kompania ... për kartonin e gjelbër- fotokopje nga arhiva e Kompanisë, e noterizuar dhe e përkthyer në gjuhën shqipe.

Po ashtu ky fakt u vërtetua edhe nga Vërtetim nga Kompania e Sigurimeve ... me numër 0306/21573 të datës 04.11.2020, në të cilën konstatohet se polisa me numër MK/..., në evidencën e kompanisë është e regjistruar si valide dhe e lëshuar në bazë të të gjitha procedurave.

Po ashtu ky fakt u vërtetua edhe nga ekstrakti i databaza e Byrosë Kombëtare të Sigurimeve, i përkthyer dhe i noterizuar.

Provat - shkresë nga Kompania ... me numër 0306/21573 e datës 04.11.2020 në origjinal, vërtetim nga noteri S.K. i datës 05.11.2020, kartoni i gjelbër i nxjerrë nga sistemi i kompanisë ..., i noterizuar dhe i përkthyer në gjuhën shqipe, njoftim nga Byroja Kombëtare për Sigurimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut e datës 06.11.2020 me numër të referencës 08.09.-497/1-2019 e motorizuar dhe e përkthyer në gjuhën shqipe, gjykatës ia ka prezantuar i akuzuari së bashku me kërkesën për hudhjen e aktakuzës. Të njëjtat janë administruar në shqyrtim gjyqësor dhe lidhur me këtë provo nuk ka pasur ndonjë vërejte nga Prokuroria e Shtetit. Këto prova gjykata e vlerësoi si të besueshme, pasi që të njëjtat ishin të lëshuar nga dy institucione të ndryshme në Republikën e Maqedonisë Veriore si, nga Byroja Nacionale e Sigurimeve e Maqedonisë dhe nga kompania e sigurimeve ..., me të cilat vërtetohet një gjendje e njëjtë faktike se kartoni i gjelbër me numër MK/08/4994705 është i lëshuar në mënyrë të rregullt.

Gjykata i analizoi edhe provat tjera të propozuar nga Prokuroria e shtetit në aktakuzë, si:

Raporti i ekspertimit i Agjencisë së Kosovës për forenzikë më numër AKF/2019-0340/2019-297 e datës 12.02.2019

Nga kjo provë Gjykata nxjerri përfundimin se letra, cilësia e letrës, logoja, mënyra e printimit në kartoni i gjelbër i MKD –së me numër serik MK/08/4994705 nuk kanë qenë në cilësinë e letrës së kërkuar, mënyrës standarde të printimit, dhe si të tillë gjykata e vlerësoi të besueshme, por përmbajtja në letër ka qenë origjinale dhe e lëshuar në mënyrë të rregullt, fakt të cilin gjykata e ka vërtetuar shkresë nga Kompania ... me numër 0306/21573 e datës 04.11.2020 në origjinal, vërtetim nga noteri S. K. i datës 05.11.2020, kartoni i gjelbër i nxjerrë nga sistemi i kompanisë ..., i noterizuar dhe i përkthyer në gjuhën shqipe, njoftim nga Byroja Kombëtare për Sigurimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut e datës 06.11.2020 me numër të referencës 08.09.-497/1-2019 e motorizuar dhe e përkthyer në gjuhën shqipe, po ashtu ky raport nuk kanë dhënë ndonjë të dhënë apo përfundim lidhur me përmbajtjen e dokumentit në fjalë.

Gjykata ka vlerësuar se i akuzuari, në rastin konkret, nuk kanë mundur ta dij se në çfarë letre apo çfarë cilësie apo mënyrë duhet të shtypet kartoni i gjelbër nga shitësi, sepse e njëjta është blerë në mënyrë të rregullt, të cilin fakt gjykata e ka vërtetuar nga dokumenti nga shkresë nga Kompania ... me numër 0306/21573 e datës 04.11.2020 në origjinal, vërtetim nga noteri S. K. i

datës 05.11.2020, kartoni i gjelbër i nxjerrë nga sistemi i kompanisë ..., i noterizuar dhe i përkthyer në gjuhën shqipe, njoftim nga Byroja Kombëtare për Sigurimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut e datës 06.11.2020 me numër të referencës 08.09.-497/1-2019 e motorizuar dhe e përkthyer në gjuhën shqipe,

Me këto prova po ashtu u vërtetua se nuk ka qenë dashja e të akuzuarit për ta kryer këtë veprë penale, po ashtu duke e marrë për bazë edhe faktin se i akuzuari veturën e ka vozitur me autorizim dhe e njëjta nuk ka qenë në emër të tijë.

Nga provat tjera të administruara si, raporti fillestar i incidentit i datës 08.02.2019, raporti i oficerit E.K i datës 08.02.2019, formular i konfiskimit të dokumenteve i datës 08.02.2019, dy fotografi të kartonit të gjelbër, Kartoni i gjelbër, nuk është arritur të vërtetohet ndonjë fakt me rëndësi vendimtare, përpos mënyrës se si është zhvilluar procedura lidhur me dyshimin për falsifikim të kartonit të gjelbër.

Gjykata me rastin e vendosjes po ashtu në këtë rast ka pasur parasysh edhe parimin in dubio pro reo.

Baza ligjore.

Gjykata duke u bazuar në nenin 364 pika 1.3 të KPP-së ka vërtetuar se nuk është provuar se e akuzuara ka kryer veprën penale Falsifikim i dokumentit nga neni 398 paragrafi 1 të KPRK-së

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Të njëjtat bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate konform nenit 454 par 1 të KPP-së.

Andaj duke u bazuar në të gjitha të cekurat më lartë gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

P.nr.146//19, datë 06.10.2022

Procesmbajtësja

Suzane Rudi

Gjyqtari

Burim Çaka

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.